

Vendim nr. 249 datë 03.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 03.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ESAT KALOSHI, përfaqësuar nga avokat Preng Frroku.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1649, datë 30.04.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, pika 1, 42, pikat 1 dhe 2, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 31 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në vitin 2008 ka filluar marrëdhëniet e punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (*DPT*), pranë së cilës ka kryer detyra të ndryshme, ku së fundmi ka kryer detyrën e inspektorit në sektorin e verifikimit në terren në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë. Po

ashtu, rezulton se Komisioni Disiplinor (KD), me vendimet nr. 192, datë 09.03.2015 dhe nr. 302, datë 10.04.2015, ka vendosur ndaj kërkuesit masat disiplinore “Mbajtje e 1/3-ës së pagës së plotë për një periudhë 3-mujore”. Me shkresën nr. 6783 prot., datë 02.03.2016 të DPT-së, Tiranë, kërkuesit i është komunikuar fillimi i procedimit disiplinor dhe kjo shkresë i është komunikuar atij bashkë me materialet shkresore për t’u paraqitur pranë KD-së.

2. Në përfundim të procedimit, me shkresën 6783/1 prot, datë 01.04.2016, kërkuesit i është njoftuar vendimi nr. 242, datë 01.04.2016 (*vendimi nr. 242/2016*) i KD-së, me të cilin është vendosur marrja e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. Sipas këtij vendimi, kërkuesi në ushtrimin e detyrës së tij ka kryer shkelje shumë të rënda. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit të KD-së nr. 242/2016.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3761 (80-2016-3799), datë 18.07.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1332, datë 29.03.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3761 të datës 18.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-1649, datë 30.04.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmban asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

6. Në datën 09.07.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë pas 2300 ditëve, në kundërshtim të hapur me nenin 60 të ligjit nr. 49/2012. Rekursi është paraqitur në datën 29.06.2018, ndërsa Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në datën 30.04.2025.

7.2. Së drejtës për t'u dëgjuar, pasi Gjykata e Lartë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa dëgjuar palët. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive e interesave të tij kushtetues e ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, publik, brenda afateve ligjore të caktuara në ligj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në këtë këndvështrim, Kolegji vëren se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

10. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në ankimin kushtetues individual Kolegji konstaton se kërkuari, ndër të tjera, ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi Gjykata

e Lartë e ka gjykuar çështjen pas një periudhe prej 2300 ditësh nga data e regjistrimit të çështjes në atë gjykatë, në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr. 49/2012.

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjeve dhe vlerësimi përfundimtar për kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pranuar se, në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës me ankim kushtetues individual, pa paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë dhe pa shfrytëzuar garancitë e mbrojtjes nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se për këtë pretendim kërkuuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Kërkuuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 30.04.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 09.07.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuuesi ka pretenduar se është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit pa dëgjuar palët.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka mbajtur qëndrimin se mospjesëmarrja e palëve gjatë fazës së shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk përbën proces të parregullt ligjor, pasi ky rregull i sanksionuar në dispozitat procedurale niset nga fakti se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit është seleksionues dhe i kufizuar në raste nga ligji, kështu që nuk ka të bëjë me shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Gjykata ka vlerësuar se është kompetencë e Kolegjit në dhomën e këshillimit të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me

kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 22, datë 06.06.2011; nr. 18, datë 18.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këtë kuptim, duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se, nga njëra anë, kjo është një çështje e mënyrës së zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, e cila vlerëson nëse në një çështje të caktuar ekziston ndonjë prej rasteve të parashikuara nga dispozitat e procedurale për shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore në prani të palëve. Pra, është në kompetencën e kolegjeve të Gjykatës së Lartë të vlerësojnë sesi do të shqyrtohet çështja dhe nëse shkaqet e rekursit janë të tilla që bëjnë që rekursi të merret në shqyrtim ose jo në seancë. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se forma e gjykimit të çështjes “*në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh*”, pra jo me pjesëmarrjen e palëve, nuk është provuar të ketë sjellë ndonjë pasojë në të drejtat e kërkuarit, për sa kohë ai i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrisë të drejtën e mbrojtjes të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar nëpërmjet paraqitjes së rekursit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

18. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.